Kronikë

# Kishte fshehur në banesë një automatik, arrestohet 40-vjeçari në Vlorë

*Pas informacioneve të siguruara uniformat blu gjetën në banesën e 40-vjeçarit në në lagjen '4 Heronjtë' një armë zjarri automatike "AK-47".*




*Foto ilustruese*

Redaksia
18 Nëntor, 16:00 | **Përditësimi: 18 Nëntor, 16:01**

Share

Një 40-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Vlorës.

Pas informacioneve të siguruara uniformat blu gjetën në banesën e 40-vjeçarit në në lagjen '4 Heronjtë' një armë zjarri automatike "AK-47".

Si provë materiale blutë sekuestruan armën si dhe 1 krehër me 29 fishekë.



LEXO EDHE:
**Moti i keq në Vlorë/ Emergjencat të pozicionuara në terren, kreu i Novoselës: Vjosa ka kohë që nuk ka dalë nga shtrati, po monitorojmë situatën**

"Në vijim të punës së pandërprerë për identifikimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale që mund të shkaktoheshin nga përdoruesit e tyre, shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "React".

Si rezultat i këtij operacioni, u arrestua në flagrancë shtetasi:

H. M., 40 vjeç, banues në lagjen "4 Heronjtë", Vlorë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 1 armë zjarri automatike "AK-47", si dhe 1 krehër me 29 fishekë", informoi sot policia.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

K.B/Shqiptarja.com

TAG: Vlore Arrestime

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 17 Nëntor, 09:56

**Hapen negociatat për gjithë kapitujt, a do anëtarësohemi në BE brenda 2030-ës?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera



Moti i keq/ Trageti i linjës Brindisi-Vlorë nuk ankorohet në port, shkak erërat e forta dhe dallgët
18 Nëntor, 10:42



Moti i keq/ Era e fortë rrëzon pemë në zonën e Skelës dhe pyllin e Sodës në Vlorë! Në qarkun e Fierit disa zona pa energji elektrike (VIDEO)
18 Nëntor, 09:23



Moti i keq/ Përmbyten 90 banesa në Bashkinë Kurbin, tërhiqet uji nga 48 shtëpi në Durrës! 5 familje të evakuara
18 Nëntor, 07:20



Moti i keq, mblidhet Komisioni i Mbrojtjes Civile në Vlorë, Prefektja: Gadishmëri maksimale, kujdes edhe nga qytetarët
17 Nëntor, 15:47



Vodhi 5 milionë lekë në 3 biznese, pranga 'skifterit' në Vlorë (VIDEO)
17 Nëntor, 15:01



Vlorë/ Lirimi i hapësirave publike, IKMT dhe Policia Bashkiake aksion në Lungomare (VIDEO)
17 Nëntor, 11:49



Moti i keq/ Autoriteti Portual Vlorë ndalon lundrimin për mjetet e vogla lundruese dhe ato të peshkimit nga mbrëmja e sotme deri mëngjesin e 19 nëntorit
16 Nëntor, 18:28



Rritet numri i 'peshkut luan' në Gjirin e Vlorës, rrezik për pushuesit dhe faunën detare
16 Nëntor, 14:29



Ministri Salla takon bletërritësit në Delvinë: Rimbursim 10% të TVSH nga janari
16 Nëntor, 13:32



Zhupa: Në Sarandë mësimi zhvillohet me dy turne dhe pa kushte! Shkolla e re u dhurua për resort
16 Nëntor, 11:02



Reshje shiu javën e ardhshme në Vlorë, Bashkia paralajmëron qytetarët: Tregohuni vigjilentë, shmangni parkimin e mjeteve në zonat me risk
15 Nëntor, 19:32



SPECIALE/ Fermerët paralajmërojnë më pak vaj ulliri në treg, rendiment i ulët, por cilësi e lartë
15 Nëntor, 18:48




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje